

EKOLOGJIZMA

ECOLOGISM

Afrim REXHEPI¹

¹Institute for Macedonian Literature, Ss. Cyril and Methodius University in Skopje

^{}Corresponding author e-mail: aa_redzepe@yahoo.com*

Abstract

Literature should be read as self-sufficient for itself, because the knowledge it has inside, the self-knowledge of man is enough to be aesthetically necessary for man, without ideological additions. In the text, the theory reveals the tendency that in every literary text, in every literary form, the uniqueness should be seen, and how that uniqueness will be positioned within the value system of literature. And when it semiosis, to be repeated and repeated, as concentrates, through the various literary forms - poetry, short story, novel, etc., and when the basic characteristics of literature are sublimated, as a construction and as a meaning, i.e. like poetics, then we will be able to talk about a certain variant of historical poetics, i.e. the history of literature, as a science of critical objective analysis, of transformations and eternities, of the strong effect of works from tradition and their models, rather than of the temporal ideological and political processes..

Keywords: biowriting, ecologism, semiosis, dialogism, history of literature, etc.

Përmbledhje

Letërsia duhet lexuar si e vetëmjaftueshme për veten, sepse mjaftojnë njohuritë që ka brenda, vetënjohja e njeriut për të qenë estetikisht e nevojshme për njeriun, pa shtesa ideologjike e politike. Në tekst, teoria nxjerr në pah tendencën që në çdo tekst letrar, në çdo formë letrare, duhet parë veçantia dhe mënyra, si pozicionohet ajo veçanti brenda sistemit të vlerave të letërsisë. Dhe kur ajo vendos temat (edhe temën e natyrës dhe ekologjizmat) përmes një procesi të caktuar të semiozës, të përsëritshme e të përsëritura, përmes formave letrare - poezi, tregim, roman etj., dhe kur ato janë karakteristika të sublimuara të letërsisë, si ndërtim dhe si kuptim, d.m.th. si poetikë, atëherë do të mund të flasim për një variant të caktuar të poetikës historike, pra historinë e letërsisë, si shkencë e analizë kritike objektive, e transformimeve dhe përjetësive, e efektit të fortë të veprave nga tradita dhe modelevë të tyre, në vend të proceseve kohore ideologjike dhe politike.

Fjalët kyçe: bioletra, ekologjizma, semioza, dialogjizmi, histori e letrësisë etj.

1. Hyrje

Letërsinë nuk e kuptojë si dokument, por si monument – definojnë Gerard Genette. Temën natyrë, pra ekologjizmen natyrë, e përcaktojmë si shenjë dhe kuptim autentik, që arrin universalitetin, si esencë e shndërruar në aktualitet përmes formave letrare, për të përsëritur dhe nxjerrë në pah përjetësinë në aktualitet. Dhe kjo nënkupton përcaktimin metodologjik, që idenë e natyrës në letërsi, e vërojmë në përsëritjen e saj historike. Ekologjizmat janë koncentrate ose esenca, të konfiguruar në forma letrare historike. Ato marrin përsipër funksionin e ripërtëritjes së dukurive natyrore, pra përsëritshmërinë e tyre në kohë, i kthen ato në konstante të përjetshme, me vlera specifike brenda një poetike të caktuar historike, gjithmonë jashtë historisë së ideve dhe konvencave politike.

Dhe kjo mund të shpjegohet përmes bioletrës, në kuptimin që format e jetës përsëriten, ashtu siç përsëriten format letrare, por nuk përsëriten veprat letrare, forma individuale që është e papërsëritshme, e përjetshme dhe unike dhe e cila përmes dialogjizmit, zbulohet nga lexuesi empirik, me përvojën e tij empirike. Pra, dukuritë letrare, të lidhura me mjedisin semiotik, bëhen origjinale, autonome dhe unike, duke kështu provokuar modelet e njëfarë poetike historike.

2. Paradigma teorike të historisë së letërsisë

Në Poetikën e tij të njohur, Aristoteli definojnë themelet teorike të poetikës strukturore. Ai përcakton poetikën në bazë të dallimit në raport me ngjarjet historike. Derisa historia tregon ngjarjet që kanë ndodhur, letërsia rrëfen ngjarjet që me njëfarë probabilitetit edhe mund të kishin ndodhur. Marrëdhëniet e tyre ndërlikohen shumë, kur ekziston tendenca për të shkruar një histori të botëve të mundshme, pra një histori të letërsisë. Teoricieni René Welek, në librin e tij të shquar *Teoria e Letërsisë*, në rubrikën *Historia e Letërsisë*, do të shtrojë pyetjen epokale: “A është e mundur të shkruhet histori letrare, domethënë të shkruhet ajo që do të jetë edhe letrare edhe historike?”

Shumica e historive të letërsisë janë ose histori shoqërore, ose histori idesh të ilustruara në letërsi, ose mbresa dhe gjykime të veçanta për vepra të veçanta të renditura, pak a shumë, në një rend kronologjik”. (Wellek, 1954: 263). Në fakt, me citimin e mëparshëm, Welek thekson se shumica e historive të letërsisë janë ose histori qytetërimesh ose vepra të zgjedhura kritike. Pra, ai kërkon të përcaktojë një model ideal të historisë së letërsisë si art, me një metodologji të qartë, një histori të letërsisë të përcaktuar vetëm me kritere estetike. Në rrjedhën e krijimeve të mëvonshme, veprat letrare kanë një strukturë, por struktura është dinamike, e cila në kuadrin e procesit historik ndryshon përmes shijes dhe ndërgjegjes së lexuesve, kritikëve dhe artistëve.

Modeli teorik i Welek dëshmon se letërsia përcaktohet si një sistem veprash letrare që ndryshojnë me shfaqjen e veprave të reja letrare, zhvillohet procesi i një tërësie të ndryshueshme të brendshme. Në tekstin *Histori ose Letërsi*, teoricieni Roland Barthes, përpiqet të vendosë dukshmërinë e ndryshimit të letërsisë në kohë. Ai thekson rezistencën e përgjithshme të historianëve të letërsisë për të kaluar nga letërsia në histori, sepse krijimi letrar ka një status të veçantë, jo vetëm që letërsia nuk mund të trajtohet si asnjë produkt tjetër historik, por edhe se kjo e veçantë e veprës është kontradiktore me historinë, me pak fjalë, vepra letrare është paradoksale, sepse, në të njëjtën kohë, është edhe shenjë e historisë, edhe refuzimi i saj.

“Kur objekt analize është institucioni letrar, metoda është historike, kur objekt analize është krijimi letrar, metoda është psikologjike. E para përcakton historinë e funksionit të letërsisë, dhe tjetra përcakton historinë e krijimit të letërsisë”. (Barthes 1960: 524-537) Kjo do të thotë se ka një histori të funksionit të letërsisë dhe ka një histori të krijimit të letërsisë. Historia e letërsisë nuk duhet të vendoset në nivelin e funksioneve letrare, por në nivelin e krijimtarisë subjektive, sepse sipas Barthes, letërsia (tërësia e objekteve dhe procedimeve, teknikave dhe

veprave) brenda strukturës së përgjithshme të një shoqërie të caktuar, zotëron fuqinë për të funksionalizuar subjektin.

Teoricieni Cvetan Todorov, në tekstin e tij *Historia e letërsisë*, mendon se historia letrare duhet të definohet si proces i kalimit nga një sistem në tjetrin, pra me diakroninë. Objekt i historisë së letërsisë nuk është gjeneza e veprave por ndryshueshmëria e tyre, pra historia letrare nuk përkon me analizën imanente në funksion të ofrimit të sistemit të tekstit, sepse një procedurë e tillë analitike është sinkronike, pjesë e një kohë të caktuar letrare. Në kontekstin e mëparshëm, Cvetan Todorov përcakton se “historia e letërsisë duhet të studiojë diskursin letrar, e jo veprat letrare, prandaj përkufizohet si pjesë e poetikës”. (Fjalori Enciklopedik 1-2, 1994:223)

Ajo që intrigon në tekst, është modeli teorik për historinë e letërsisë së Gérard Genette. Në artikullin e tij *Poetika dhe historia*, ai beson se gjatë leximit të teksteve letrare, kritika takohet me teorinë, domethënë me poetikën, kurse poetika, si teori e formave letrare, takohet me historinë. Në kontekst, Genette i referohet kritikës formaliste dhe distancimit të saj nga historia si një shtyrje metodologjike e përkohshme, “dhe ky lloj i kritikës, të cilën pa hezitim do ta përcaktojmë si teori të formave letrare ose si poetikë, ndonjëherë takohet me historinë”. (Genette, 1972:14)

Genette njih dy paradigma të historisë së letërsisë: Paradigma e parë e historisë së letërsisë lidhet me renditjen kronologjike të monografive që nuk mund të përbëjnë historinë, dhe paradigma e dytë e historisë së letërsisë lidhet me propozimin e Lanson-it, jo një histori e letërsisë, por një histori letrare në të cilën do të inkuadroheshin: tabloja e jetës letrare të kombit, historia e kulturës, veprimtaritë e personave të panjohur që lexojnë, si dhe individëve të njohur që kanë shkruar. Një histori letrare si pjesë e historisë shoqërore, e cila i heton veprat letrare si dokumente të ndjeshme me prirje ideologjike. Për dallim nga paradigmat e mëparshme teorike, Genette definon një model të tillë të historisë së letërsisë, që përcakton vetë letërsinë, e jo kushtet e jashtme, letërsinë si të tillë, për vete, pra letërsinë, veprën letrare, jo si dokument (historik), por si monument.

“Mendoj se në letërsi vepra nuk është një objekt historik, njëkohësisht i përhershëm dhe i ndryshueshëm, janë elementet që e tejkalojnë veprën, dhe nga të cilat lind loja letrare dhe ato mund t’i quajmë thjesht forma. Ato janë: kodet retorike, procedimet narrative, strukturat poetike etj”. (Genette, 1972: 15) Genette pohon se ekziston një histori e formave letrare, ashtu siç ekziston një histori e formave dhe teknikave estetike, dhe se format, me kalimin e kohës, qëndrojnë dhe ndryshojnë. Në kontekst, gjithmonë sipas Genette, veçohen formalistët rusë, të cilët futën nocionin e evolucionit letrar, ndërsa Eysenbachum beson se "teoria arriti të drejtën për t'u bërë histori". Me këtë Genette dëshmon se historia e formave letrare mund të përkufizohet si histori e letërsisë dhe se pa zhvillimin e nevojshëm të teorisë letrare, nuk mund të ketë një histori të letërsisë, e cila sipas një lloj procesi do të përmbushë metodat e përgjithshme historike, si për shembull, problemet e periodizimit ose raporteve midis tyre, shkëmbimit dhe lëvizjes së vazhdueshme të sinkronisë dhe diakronisë etj.

3. Letërsia dhe ekologjia

Për Ekokritikën, që është një perspektivë e re e studimeve letrare, shënojmë përcaktimin teorik të saj dhe ripozicionimin në historinë e letërsisë shqipe. Në tekstin për historinë e formave letrare *Histori e letërsi*, i ndikuar nga vepra *Arkeologjia e dijes e Mishel Fukosë*, Genette përcakton faktin që letërsia nuk duhet kuptuar si dokument historik, por si monument. Në kontekst, duke iu referuar modelit teorik të Sabri Hamitit për një poetikë historike të letërsisë shqipe, tema natyrë, në leximin tim, përcaktohet si shenjë autentike dhe si kuptim që kap universalitetin, si esencë e shndërruar në aktualitet përmes formave letrare, me tendencë të përsëritet dhe të theksojë përjetësinë në aktualitet. Dhe kjo nënkupton procedimin metodologjik, që idenë për natyrën në letërsi, e përcjellim në lëvizshmërinë e vet historike.

Në fakt, shpjegimi bëhet funksional në kuptimin e koncepteve teorike të Sabri Hamitit, përmes Bioletrës ose Jetëshkrimit, në kuptimin format e jetës përsëriten, ngjashëm siç përsëriten format letrare, por nuk përsëriten veprat letrare, sepse veprat letrare janë forma individuale të përhershme, zbulohen nga lexuesi empirik, përmes përvojës së gjallë, reale dhe empirike. Fenomeni letrar siç është edhe tema e natyrës, e lidhur me ambientin semiotik, bëhet origjinale, autonome dhe unike, duke kështu e provokuar skemën për një poetike historike të letërsisë shqipe.

Në esenë antologjike *Letërsia dhe Ekologjia: Një Eksperiment Ekokritik* (1978), William Ruckert, e përkufizon ekokritikën si: “zbatim të ekologjisë dhe koncepteve ekologjike në studimin e letërsisë, sepse ekologjia (si shkencë e si disiplinë) ka rëndësinë më të madhe për të tashmen dhe të ardhmen e botës”. (Ruckert, 1996: 107) Në këtë kontekst, interaktiva e mundshme midis letërsisë dhe natyrës shqyrtohet nga këndvështrimi i koncepteve ekologjike. Ekokritika kërkon të gjejë gjuhën e përbashkët midis njeriut dhe jonjeriut për të treguar se si ato mund të bashkëjetojnë në mënyra të ndryshme, pasi çështjet mjedisore janë bërë pjesë integrale e ekzistencës sonë.

Ky është një problem esencial me të cilën merret ekokritika në përpjekjen e saj për të gjetur një pozicion më të ndërgjegjshëm mjedisor në studimet letrare. Ekokritika si koncept teorik dhe kritik shprehet në antologjinë e titulluar *Leximi Ekokritik: Kuptimet në ekologjinë letrare* (1996) e redaktuar nga Harold Fromm e që studion raportin ndërmjet letërsisë dhe natyrës. Në librin shpjegues, të gjitha tekstet apo interpretimet tekstuale regjistrohen në formë eseistike, kryesisht nga pikëpamja ekokritike. Dhe ja një sinjal në krijimin e një paradigme të re interpretive letrare, të një lloji të ri të kritikës letrare të quajtur ekokritikë. Ekokritika sjellë ndryshime në studimet letrare, duke e lidhur gjithmonë kritikën dhe teorinë letrare me problemet mjedisore.

Është me rëndësi diskursive, t’i kthehemi tekstit *Letërsia dhe Ekologjia* e Ruckert, sepse përveç që është teksti i parë eksperimental për interaktivën letërsi – ekokritikë, shënohet edhe pasiguria letrare-historike dhe letrare-teorike e tij. Ai duhet të kishte parasysh faktin se letërsia e konfirmon vlerën e saj përmes funksionit estetik, dhe jo përmes relevancës tematike, jashtë letërsisë. Metodologjia e tij e aplikuar për lidhjen e “çdo gjëje me gjithçka”, si fenomenet natyrore, ashtu edhe fenomenet kulturore, në kuptimin që poezia i ngjan lëndëve djegëse fosile apo një formë ruajtjeje karburanti që lirohet në raport me lexuesin, një lloj paralelizmi me efekt komik, mbetet në fazën e eksperimentit (të dështuar).

Vetëdija teoriko – letrare dhe vetëdija letrare – historike e Ruckert – it, nuk është e përcaktuar sipas procedimeve metodologjike për një sistem të plotë, por për të përcaktuar relevancën tematike. Në esenë e tij antologjike, Ruckert “mendon që letërsia e vërteton vlerën e saj, jo përmes konfigurimit artistik, por përmes funksionalitetit të temave”, dhe një pragmë e tillë e teorisë letrare dhe filozofike, imponon procesin lëvizës: prej ontologjisë kah politika, duke e përjashtuar strukturën e brendëshme e dinamike të veprave letrare, edhe kur e interpreton poezinë, duke krijuar paralelizëm midis energjisë krijuese të poetit, me lëvizjen e ujit në natyrë. Funksionimi i dimensionit sinkronik përkufizon fenomenin natyrë, idea e natyrës në letërsi, nuk mund të diakronizohet, të përcaktohet në kohë.

Në tekst është funksional edhe dallimi ndërmjet ekokritikës dhe ekologjisë së letërsisë (eko-letërsisë). Ekologjia e letërsisë (eko-letërsia), përfshin gjithë gamën e veprave letrare, përfshinë fiksionin, poezinë dhe kritikën, përfshinë ato procedura metodologjike në studimin e letërsisë që kanë të bëjnë me natyrën imagjinare të letërsisë: biosemiotikën e Iksel-it, poetikën e hapësirës së Bachelard-it, gjeopetikën e Kenneth White-it, kronotopin e Bakhtin-it, tematologjinë dhe historinë e ideve, me ekokritikën. Pra, dallimi midis ekokritikës dhe eko-letërsisë është i domosdoshëm dhe funksional për fenomenin natyrë sepse duhet ditur fakti që ekologjia e letërsisë përfshin në vete edhe ekokritikën.

Teoria e letërsisë shqipe ka një model teorik që korrigjon dhe nuk lejon që gabimet e Ruckert- it, të përfshihen edhe në kodin e letërsisë shqipe. Sabri Hamiti, duke i shfrytëzuar paradigmat teorike të historive letrare në vijim, ndërtoi një model të veçantë për një poetikë historike të letërsisë shqipe e që teoretikisht, pretendohet të modelohet në histori të letërsisë shqipe. Modelin teorik në fjalë, akademik Kujtim Shala e kërkon në shkrirjen e modelit teorik të Gerard Genett-it dhe të Cvetan Todorovit, kurse në aspektin estetik dhe filozofik, unë do të thoja një ndikim i librit epokal *Arkeologjia e dijës* e Michel Foucault dhe një ndikim i estetikës empirike të Gilles Deleuze.

Letërsia duhet lexuar si e vetëmjaftueshme për veten, sepse mjaftojnë njohuritë që ka brenda, vetënjojha e njeriut për të qenë estetikisht e nevojshme për njeriun, pa shtesa ideologjike e politike. Në tekst, teoria nxjerr në pah tendencën që në çdo tekst letrar, në çdo formë letrare, duhet parë veçantia dhe mënyra, si pozicionohet ajo veçanti brenda sistemit të vlerave letrare. Dhe kur ajo vendos temat (edhe temën e natyrës dhe ekologjizmat) përmes një procesi të caktuar të semiozës, të përsëritshme e të përsëritura, përmes formave letrare - poezi, tregim, roman etj., edhe kur ato janë karakteristika të sublimuara të letërsisë, si ndërtim dhe si kuptim, d.m.th. si poetikë, atëherë do të mund të flasim për një variant të caktuar të poetikës historike, pra historinë e letërsisë, si shkencë e analizë kritike objektive, e transformimeve dhe përjetësive, e efektit të fortë të veprave nga tradita dhe modeleve të tyre, në vend të proceseve kohore ideologjike dhe politike.

Pra, veprat letrare si bie fjala poezitë bukolike të Naim Frashërit apo poezitë e Lasgush Poradecit, (të manifestuara në forma e nënforma letrare, me temën e natyrës, me ekologjizma mjedisore), si dukuri letrare, janë të lidhura gjenetikisht me strukturën organike të identitetit kulturor, sepse gjuha shqipe është kujtesë, sepse gjuha shqipe kujton.

4. Përfundimi

Sipas modelit teorik për një histori të poetikës shqipe të Sabri Hamitit, shkrimi dhe leximi empirik letrar si procese njerëzore komplekse dhe tejet të ndërlidhura e kanë burimin tek individit dhe bota e tij, e jo në rrethanat shoqërore dhe ideologjike të kolektivit. Kjo është kërkesa që letërsia t'i kthehet natyrës së saj të vërtetë, krijimit të vlerave shpirtërore dhe kënaqësia e njohjes së këtyre vlerave. Bioletra ose jetëshkrimi, është një ftesë për t'u kthyer në fillim, në pafajësinë, në zbulimin e vetes dhe të botës, pa pranuar konvenca ideologjike e politike. Në këtë hapje të përgjithshme, krijuesi takohet me lexuesin e kohës së tij apo të kohëve të tjera, për të relativizuar kohën me përjetësinë e artit.

Ekologjia i nevojitet letërsisë, si një nga këndvështrimet e mundshme teorike, ndryshe nga sa pretendojnë Ruckert dhe shumë studiues, letërsia vërtetohet përmes çështjeve ekologjike, jo si vazhdimësi e ideologjisë, por, në ekzistencën e saj historike, si letërsi. Kështu, vepra, përmes bioletrës, i afrohet estetikës, funksionit të saj origjinal, unik e parësor, asaj që e bën letërsinë letërsi edhe kur poeti i drejtohet natyrës. Duhet pasur parasysh faktin se format janë të përjetshme: romani, tregimi, poezia, por mbetet procesi empirik, pra bioletra, e krijuar përmes dialogjizmit krijim - lexim, të cilat janë të veçanta dhe origjinale, të cilat përsërisin temat e natyrës gjatë gjithë jetës dhe kohës (historisë), autori përmes krijimit dhe lexuesi përmes leximit empirik dhe të përsëritur.

Jo si konstrakte diskursive të lojërave gjuhësore, por si entitete të gjalla, reale e faktike, ngjashëm me idenë e hiperobjektit të Timotij Morton, ngrohja globale, një hiperstrukturë që ndikon në çdo gjë. Gjykuar sipas modelit teorik të Sabri Hamitit, ndikim domethënës i ekokritikës në studimin e historisë së letërsisë shqipe, mund të jetë vetëm një rivlerësim i mundshëm i perspektivës letrare - historike, e që nuk ka arsye shkencore të devijojë nga kanuni i letërsisë shqipe.

Referencat

- [1]. Barthes Roland. (1960) *Histoire et littérature: à propos de Racine*. In: Annales. Economies, sociétés, civilisations. 15^e année, n. 3,.
- [2]. Borges, H.L. (2019) *Pavdekesia*, Tirane.
- [3]. Genette, Gerard. (1972) *Figures III*, Art, Poétique et histoire, Paris.
- [4]. Howarth, William. (1996) *Some Principles of Ecocriticism*, The Ecocriticism Reader: Landmarks in Literary Ecology, The University of Georgia Press, London.
- [5]. Hamiti, Sbari. (2010) *Poetika shqipe*, Prishtine.
- [6]. Rueckert, William. (1996) *Literature and Ecology*, The Ecocriticism Reader: Landmarks in Literary Ecology, The University of Georgia Press, London, 105-123.
- [7]. Solar, Milivoj. (2010) *Ukus, mitovi, poetika*, Zagreb.
- [8]. Glotfelty Ch / Fromm H. (1996) *The Ecocriticism Reader: Landmarks in Literary Ecology*, Athens: University of Georgia Press, London.
- [9]. Wellek / Warren (1954) *Theory of literature*, Jonathan Cape, Thirty Bedford Square, London.
- [10]. Ulig, Klaus. (2010) *Teorija književne istorije - nacela i paradigme*, Beograd.
- [11]. Morton, Timothy. (2013) *Hyperobjects: Philosophy and Ecology after the End of the World*, Minneapolis, London: University of Minnesota Press.